

32003R1217

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1217/2003 e 4 korrikut 2003 që përcakton karakteristikat e përbashkëta për programet e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 169, 08/07/2003 fq. 0044 – 0048

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1217/2003 e 4 korrikut 2003 që përcakton karakteristikat e përbashkëta për programet e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Komisioni i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit e 16 dhjetorit 2002 që vendos rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil [1], dhe në veçanti neni 7 pika 1 e saj,

Duke pasur parasysh se:

(1) Hartimi dhe zbatimi i një programi të kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar nga çdo Shtet Anëtar është thelbësor për të siguruar efektivitetin e programeve të tij të sigurisë së aviacionit civil kombëtar në përputhje me nenin 5 pika 3 e Rregullores (KE) nr. 2320/2002.

(2) Karakteristikat për programin e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar që do të zbatohet nga Shtetet Anëtar duhet të sigurojë një përfaqje të harmonizuar në këtë drejtim. Për rrjedhojë, një rregullore është instrumenti më i përshtatshëm për këtë qëllim.

(3) Monitorimi i programeve të kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar në nivel Komuniteti kërkon një përfaqje të harmonizuar me vlerësimin e përputhjes në nivel kombëtar.

(4) Për të qenë të efektshme, auditimet që do të ndërmerren nën përgjegjësinë e autoritetit të përshtatshëm duhet të kryhen rregullisht. Ato nuk duhet të kufizohen për sa i takon temës, fazës ose momentit në të cilin ato kryhen. Ato duhet të marrin format më të përshtatshme për të siguruar efektshmërinë e tyre.

(5) Përparësi duhet t'i jepet zhvillimit të një metodologjie të përbashkët të hollësishme për auditimet.

(6) Është i nevojshëm zhvillimi i një mënyre të harmonizuar të raportimit mbi masat e marra për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj rregulloreje dhe mbi situatën e sigurisë së aviacionit në aeroportet në territoret e Shteteve Anëtare.

(7) Programet e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar duhet të bazohen mbi praktikatat më të mira. Praktikatat e tilla më të mira duhet të ndahen ndërmjet Shteteve Anëtare.

(8) Masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil.

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

**KAPITULLI I
OBJEKTIVI DHE PERKUFIZIME**

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakteristikat e përbashkëta për programin e kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil kombëtar, që do të zbatohet nga çdo Shtet Anëtar. Kjo përfshin vendosjen e kërkesave të përbashkëta për programet e kontrollit të cilësisë, një metodologji të përbashkët për auditimet që do të ndërmerren dhe kërkesat e përbashkëta për audituesit.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “autoriteti i përshtatshëm” nënkupton autoritetin kombëtar të përcaktuar nga një Shtet Anëtar sipas nenit 5 pika 2 e Rregullores (KE) nr. 2320/2002 për të qenë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të programit të tij të sigurisë së aviacionit civil kombëtar;
2. “auditim” nënkupton çdo procedurë ose proces i përdorur për monitorimin e përputhshmërisë, i ndërmarrë në nivel kombëtar. Ai mbulon auditimet e sigurisë, inspektimet, sondazhet, testimet dhe hetimet;
3. “auditues” nënkupton çdo person që kryen auditimet në nivel kombëtar;
4. “mangësi” nënkupton dështim për të përmbushur kërkesat e sigurisë së aviacionit;
5. “inspektim” nënkupton një shqyrtim të zbatimit të një ose më shumë aspekteve të masave të sigurisë dhe procedurave, me qëllim për të përcaktuar se sa me efektivitet ato janë kryer;
6. “hetim” nënkupton një shqyrtim të një incidenti të sigurisë dhe një shpjegim të shkakut të tij, me qëllim për të mënjeluar përsëritje dhe për të konsideruar veprimin ligjor;
7. “programi i kontrollit të cilësisë” nënkupton programin e kontrollit të cilësisë së aviacionit civil kombëtar;
8. “auditim i sigurisë” nënkupton një shqyrtim të thellë të të gjitha aspekteve të masave dhe procedurave të sigurisë, me qëllim për të përcaktuar nëse ato po kryhen mbi baza të vazhdimësisë dhe të një standardi të qëndrueshëm;
9. “incident i sigurisë” nënkupton një ngjarje me ngjyrim negativ për sigurinë dhe mbrojtjen e personave dhe pronës;
10. “sondazh” nënkupton një vlerësim të veprimeve me qëllim për të përcaktuar nevojat e sigurisë. Kjo përfshin identifikimin e dobësive të cilat mund të shfrytëzohen për të kryer një akt të ndërhyrjes së paligjshme, pavarësisht nga zbatimi i masave dhe procedurave të sigurisë dhe rekomandimit të masave mbrojtëse kompensuese të barabarta me rrezikun për të trajtuar çdo rrezik të identifikuar.
11. “test” nënkupton një provë të masave të sigurisë së aviacionit, ku autoriteti i përshtatshëm paraqet ose simulon një plan për të kryer një akt të paligjshëm për qëllimin e shqyrtimit të efikasitetit dhe zbatimit të masave ekzistuese të sigurisë.

KAPITULLI II KËRKESAT E PËRBASHKËTA PËR PROGRAMET E KONTROLLIT TË CILËSISË

Neni 3

Kompetencat e autoritetit të përshtatshëm

Me qëllim për të siguruar efektshmërinë e programit të tij të sigurisë së aviacionit civil kombëtar, Shtetet Anëtare i sigurojnë autoritetit të përshtatshëm kompetencat e nevojshme për zbatim.

Neni 4

Përmbajtja e programit të kontrollit të cilësisë

1. Programi i kontrollit të cilësisë përmban të gjitha masat e nevojshme monitoruese të kontrollit të cilësisë të marra për të vlerësuar mbi baza të rregullta, zbatimin e programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar duke përfshirë politikat mbi të cilat bazohen.

2. Programi i kontrollit të sigurisë përfshin dhe trajton elementet e mëposhtëm:

(a) strukturën, përgjegjësitë dhe burimet organizative;

(b) përshkrimet e punës dhe kualifikimet e të gjithë audituesve përgjegjës për kryerjen e programit të kontrollit të cilësisë;

(c) aktivitete funksionale monitoruese, përfshirë llojet, qëllimin, përmbajtjen, shpeshësinë dhe fokusin e auditimeve të sigurisë, inspektimeve, sondazheve dhe testeve si dhe klasifikimi i përputhshmërisë dhe qëllimi dhe përgjegjësitë e hetimeve sa herë janë të zbatueshme;

(d) aktivitete të ndreqjes së mangësive që sigurojnë hollësi, në lidhje me raportimin e mangësive, ndjekjen dhe ndreqjen me qëllim për të siguruar në mënyrë të efektshme përputhshmëri me kërkesat e sigurisë së aviacionit;

(e) masat zbatuese; dhe

(f) komunikimet dhe raportimet e aktiviteteve të ndërmarra, dhe niveli i përputhshmërisë së kërkesave të sigurisë së aviacionit.

Neni 5

Monitorimi i përputhshmërisë

1. Zbatimi i programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar duhet të monitorohet.

2. Monitorimi duhet të ndërmerret në përputhje me programin e kontrollit të cilësisë, duke marrë në konsideratë nivelin e rrezikut, llojin dhe natyrën e punëve, standardin e zbatimit dhe faktorë të tjerë, dhe vlerësimet të cilat do të kërkojnë monitorime më të shpeshta.

3. Menaxhimi, vendosja e prioritetëve dhe organizimi i programit të kontrollit të cilësisë duhet të ndërmerren në mënyrë të pavarur nga zbatimi funksional i masave të marra, sipas programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar.

Neni 6

Raportimi

1. Shtetet Anëtare i dorëzojnë çdo vit Komisionit një raport mbi masat e marra për të përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj rregulloreje dhe mbi situatën e sigurisë së aviacionit në aeroportet e gjendura në territorin e tyre. Udhëzimet për raportimin parashtrihen në Shtojcën I.

2. Periudha e referencës për raportin do të jetë 1 janar – 31 dhjetor. Raporti dorëzohet dy muaj pas përfundimit të periudhës së referencës. Në raste përjashtimore, një raport dorëzohet në fund të shkurtit 2004 për periudhën 19 korrik deri 31 dhjetor 2003.

KAPITULLI III METODOLOGJIA E PËRBASHKËT PËR AUDITIMET

Neni 7 **Kryerja e auditimeve**

Aktivitetet e monitorimit të përputhshmërisë përfshijnë si aktivitetet e lajmëruara ashtu dhe ato të palajmëruara.

Neni 8 **Klasifikimi i përputhshmërisë**

Auditimet, inspektimet dhe testet e sigurisë vlerësojnë zbatimin e programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar duke përdorur sistemin e harmonizuar të klasifikimit të përputhshmërisë që parashtrohet në Shtojcën II.

KAPITULLI IV KËRKESAT E PËRBASHKËTA PËR AUDITËT

Neni 9 **Disponueshmëria e audituesve**

Çdo Shtet Anëtar merr masat e përshtatshme për të siguruar që një numër i mjaftueshëm audituesish janë në gjendje të kryejnë të gjitha aktivitetet e monitorimit të përputhshmërisë.

Neni 10 **Kriteret e kualifikimit për audituesit**

1. Çdo Shtet Anëtar siguron që audituesit që kryejnë funksione në emër të autoritetit të përshtatshëm kanë kualifikimet e përshtatshme, të cilat përfshijnë përvojë të mjaftueshme teorike dhe praktike në fushën përkatëse.

2. Audituesit kanë:

(a) një kuptim të mirë të programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar dhe si ai zbatohet për funksionet që shqyrtohen;

(b) kur është e përshtatshme, njohuri të masave më të rrepta siç zbatohen në Shtetet Anëtare të interesuara dhe vendndodhja që shqyrtohet;

(c) njohuri të mirë pune të teknologjive dhe teknikave të sigurisë;

(d) njohuri të parimeve, procedurave dhe teknikave të auditimit;

(e) njohuri pune të funksioneve që shqyrtohen.

KAPITULLI V DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 11

Ndarja e praktikave më të mira

Shtetet Anëtare informojmë Komisionin për praktikat më të mira, në lidhje me programet e kontrollit të cilësisë, metodologjitë e auditimit dhe audituesit. Komisioni e ndan këtë informacion me Shtetet Anëtare.

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel, 4 korrik 2003.

Për Komisionin

Loyola De Palacio

Zëvendëspresident

(1) GZ L 355, 30.12.2002, fq. 1.

SHTOJCA IUdhëzime për raportimin për Komisionin

Struktura, përgjegjësitë dhe burimet organizative

- Mënyrat e organizimit, përgjegjësitë dhe burimet e kontrollit të cilësisë, duke përfshirë ndryshimet e planifikuara për të ardhmen (shiko neni 4 pika 2 gërma a)
- Numri i audituesve – aktual dhe të planifikuar (shiko nenin 9)
- Kualifikimi i audituesve – lehtësirat trajnuese të përdorura dhe burimet (shiko nenet 4 pika 2 gërma b dhe 10)
- Shpjegim, nëse programi i kontrollit të cilësisë për këtë pjesë nuk po zbatohet plotësisht.

Aktivitetet funksionale monitoruese

- Statusi i zbatimit të aktiviteteve funksionale: llojet, qëllimi, përmbajtja, shpeshtësia dhe fokusi i të gjitha aktiviteteve monitoruese (shiko neni 4 pika 2 gërma c), duke përfshirë numrin e auditimeve për aeroport dhe për zonën e kërkesave të matjes së sigurisë (p.sh. e drejta e kontrollit, mbrojtja e avionit, kontrolli i bagazhit të dorës) kur është e përshtatshme dhe e mundur
- Përpjestueshmëria e aktiviteteve funksionale monitoruese në lidhje me aktivitetet e fushës (shiko neni 5 pika 2)
- Niveli i përputhshmërisë për zonë të kërkesave të sigurisë së aviacionit (p.sh. e drejta e kontrollit, mbrojtja e avionit, kontrolli i bagazhit të dorës) (shiko neni 8)

- Shpjegim, nëse aktivitetet funksionale nuk janë zbatuar plotësisht.

Aktivitetet e ndreqjes së mangësive

- Statusi i zbatimit të aktiviteteve të ndreqjes së mangësive (shiko neni 4 pika 2 gërma d)

- Zonat kryesore të interesuara në lidhje me zbatimin e kërkesave të sigurisë së aviacionit (p.sh. e drejta e kontrollit, mbrojtja e avionit, kontrolli në ekran i bagazhit të dorës)

- Aktivitetet kryesore të ndërmarra ose të planifikuara që synojnë ndreqjen (p.sh. trajnime, seminare dhe programe nxitëse për ndërgjegjësimin e sigurisë)

- masat zbatuese të përdorura (shiko neni 4 pika 2 gërma e).

Situata e sigurisë së aviacionit në aeroporte

- Konteksti i përgjithshëm i situatës së sigurisë së aviacionit në aeroportet në Shtetin Anëtar.

SHTOJCA II Sistemi i harmonizuar i klasifikimit të përputhshmërisë

Klasifikimi i mëposhtëm i përputhshmërisë zbatohet për të vlerësuar zbatimin e programit të sigurisë së aviacionit civil kombëtar.

	Audit i sigurisë	Inspektim	Provë
Plotësisht i përputhshëm	√	√	√
I përputhshëm, por përmirësimi është i kënaqshëm	√	√	√
I papërputhshëm/vetëm mangësi të vogla	√	√	√
I papërputhshëm/mangësi të mëdha	√	√	√
I pazbatueshëm	√	√	
I pavërtetuar	√		